



BASHKIA MIRDITË
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
PRILL 2025

Nr. Rendor	Data e Kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
10	04.04.2025	Kërkesë për Informacion	11.04.2025	Kthyer përgjigje në bazë të kërkesës.	E plotë	Pa pagesë
11	14.04.2025	Kërkesë për informacion për transparencë në buxhetin lokal.	28.04.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, drejtuar Bashkisë Mirditë, mbështetur në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju informojmë si më poshtë vijon: 1. Cili është buxheti total i Bashkisë Mirditë për sektorin e arsimit për vitin aktual dhe vitin e kaluar? Në buxhetin total të Bashkisë Mirditë për sektorin e arsimit përfshihen; pagesat për të punësuarit në çerdhet, kopshte dhe arsimin 9- vjeçar. Në këtë buxhet përfshihen edhe pagesat për konvikt, mensa, ngrohje ndriçim, pastrim, me pak fjalë të gjitha shërbimet e nevojshme. Për vitin e kaluar buxheti për arsimin ishte 143394458 lek ne total ku 10% e totalit shkon për shërbimet për PAK ., ndërsa për vitin aktual është 160207892 lek. 2. Cili është buxheti total për infrastrukturën në	E plotë	Pa pagesë

shëndetësi për vitin aktual dhe vitin e kaluar?

Për sa i përket kësaj pyetje, duhet ti drejtoheni Drejtorisë së Spitalit Rrëshen, pasi nuk kemi informacionin e duhur.

3. A ka një ndarje të veçantë buxhetore për shërbimet për personat me aftësi të kufizuara në arsim dhe shëndetësi? Nëse po, sa është kjo shumë dhe si përdoret?

Kemi një fond të veçantë për trajtimin e personave me aftësi ndryshe i akorduar nga Shërbimi Social Shtetëror për pagesat bazë të percaktuar në ligj, ndërsa për trajtime të vecanta nuk kemi një fond të detajuar për këtë qëllim, por theksojmë se për ta përfshirë sadopak dhe për të përfituar nga këto fonde janë punësuar 7 persona, që përfitojnë direkt nga buxheti i Bashkisë. Në projektin e nxitjes së punësimit janë punësuar 2 persona me aftësi ndryshe ku trajtohen me 20000 lekë në muaj dhe siguracione. Nga ana e bashkisë është miratuar një buxhet për familjet në nevojë e në vecanti ato që kanë në perberje të tyre persona me aftësi ndryshe. Ky buxhet për vitin e kaluar ishte 3.000000 lekë, ku 40% e familjeve në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi ndryshe dhe këtë vit ky fond është 4.000000 lekë.

4. Cilat janë institucionet arsimore në territorin e bashkisë që ofrojnë shërbime për nxënësit me aftësi të kufizuara?

Shkolla, kopshtet, çerdhet dhe konvikti.

5. A janë të përfshira shpenzimet për infrastruktura të përshtatshme (aksesueshmëri fizike) në shkollë dhe qendra shëndetësore në buxhetet përkatëse?

Po janë të përfshira ku pjesa më e madhe është përdorur për aksesueshmëri fizike për këto persona, për ta bërë

			sa me te lehtë levizjen e tyre dhe për të marre sherbimet e nevojshme. 6. Sa është numri i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime arsimore dhe shëndetësore në territorin e bashkisë? Numri i personave me aftesi ndryshe është 776 të ndarë në 535 paaftesi, 169 Verbëri e 45 paraplegjik. Nga këto, shërbime arsimore dhe shëndetësore përfitojne 45 persona, të gjithë sipas nevojave. 7. A ka staf të trajnuar për të punuar me persona me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore? Nëse po, sa persona janë dhe në cilat institucione? Në institucionet arsimore ka staf të trajnuar duke filluar nga kopshti ku punojnë 1 psikologe dhe 2 mësues ndihmës të specializuar dhe në shkolla punojnë 25 punonjës të ndarë: 6 shërbim psiko-social e 19 mësues ndihmës. 8. A janë planifikuar fonde për trajnime të stafit arsimor për çështje të lidhura me PAK? Deri më tani nuk ka patur ndonje fond të vecantë, por në raste të vecanta mbulohen nga fondi i përgjithshëm për arsimin. 9. A ofron Bashkia ndihmë financiare apo logjistike për familjet e personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar akses në arsim dhe shëndetësi? Po. 10. A është përfshirë ndonjë përfaqësues i komunitetit të PAK në procesin e hartimit të buxhetit ose në konsultimet publike?		
--	--	--	---	--	--

			Janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në konsultimet publike dhe në hartimin e buxhetit dhe projekteve të ndryshme. 11. A ka bashkia ndonjë program për mbështetjen psikologjike ose sociale të PAK në kuadër të shëndetit publik? Nëse po, ju lutem na jepni informacion të detajuar lidhur me këto programe. Bashkia nuk ka ndonjë program specifik të miratuar, por Shërbimi Social ka në përbërjen e tij një psikologe, e cila ofron shërbim psikologjik dhe merret direkt me trajtimin e çështjeve të caktuaralidhur me PAK. 12. A janë evidentuar nevojat e PAK përmes ndonjë studimi lokal ose procesi vlerësimi të komunitetit? Nevojat e PAK janë evidentuar nëpërmjet grupeve të punës, të krijuar nga stafi dhe Koordinatorja e Barazisë Gjinore. 13. Cilat janë burimet e financimit për shërbimet për PAK? A ka fonde të dedikuara nga qeveria qendrore, donatorë ose projekte të veçanta. Nuk ka fonde te vecanta. Kemi aplikuar po pa rezultat. 14. Si sigurohet transparenca dhe publikimi i të dhënave buxhetore për qytetarët, veçanërisht për grupet vulnerabël si personat me aftësi të kufizuara? Nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë Mirditë, afimishimeve publike dhe nga punonjësit administrative përkatës. <i>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!</i>		
--	--	--	---	--	--

12	30.04.2025	Kërkesë për informacion për vënie në dispozicion të dokumentacionit për Hec -Shpërdhaza	27.05.2025	Vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar	E plotë	Pa pagesë
----	------------	---	------------	--	---------	-----------